



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

RR E G U L L O R E
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA,
NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE, 01. NR. 016-32277 E DT. 19.03.2014

Gjilan, tetor 2015

Në bazë të nenit 12.2 pika c), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008) dhe nenit 38 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 dhe në zbatim të dispozitave të kreut II të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.2008), Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur më datën **29.12.2015**, miraton:

RREGULLOREN

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSA,
NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE, 01. NR. 016-32277 E DT. 19.03.2014

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoja komunale 01. nr. 016-32277 të dt. 19.03.2014.

Neni 2

1. Te neni 5 i rregullores bazë:

- tarifa 2.2 riformulohet dhe teksti ka këtë përmbajtje: **“për prerjen e rrugëve dhe trotuareve me kubëza betoni, beton e të ngjashme”** dhe pas kësaj tarife shtohet tarifë e re me këtë përmbajtje: **“2.3 për prerjen (gropimin) e rrugëve dhe trotuareve të pa asfaltuara, parqeve etj, për 1m².....10.00 €”**
- tarifa “2.3” sipas radhitjes bëhet “2.4”;
- tarifa 6, renditet pas tarifës 9 riformulohet dhe teksti ka këtë përmbajtje: **“10. Shfrytëzimi i hapësirës publike për pirje të duhanit (objekt i përkohshëm montues me pëlqim të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUPMM)”**: “10.1. zona I për m² ----- 2.50” dhe “10.2. zona e II për m² -- 2.00”;
- pas tarifës 12 shtohet tarifë e re me këtë përmbajtje: **“Qarkullimi i ekraneve elektronike reklamuese (lëvizëse) nëpër qytet dhe qëndrimi (vendosja) në hapësira publike: “12.1 - tarifa ditore për 1m² 2.00, “12.2 - tarifa mujore për 1m² 10.00” dhe 12.3 - tarifa vjetore për 1m² 100.00”**;
- shuma e tarifës “25”, nga “40.00”, zbret në “30.00”;
- pas tarifës 27 shtohet tarifë e re me këtë përmbajtje: **“Leja për hyrje mujore në qytet me automjet transportues për mallra komerciale dhe bartjen e materialit ndërtimor mbi 3.5 ton-tarifa mujore 200.00”**;
- pas tarifës 37 shtohet tarifë e re me këtë përmbajtje: **“Leja për rregullimin e një varri nga familjarët10.00” dhe “Leja për punë në varreza nga ndërmarrja publike apo kompania e specializuar... tarifa vjetore... 100.00”**;
- shuma e tarifës 39 nga “0.50”, zbret në “0.20”;
- shuma e tarifës 40 nga “15”, zbret në “10”;
- shuma e tarifës 41 nga “0.50”, zbret në “0.20”;
- tarifa nr. 43, 44 dhe 45 fshihen.
- paragrafi 2, nënparagrafi 2.4. pas fjalës **“ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefonik etj”** i shtohet fjala **“donatorët”**;

- pas paragrafit 11 shtohet paragraf i ri me këtë përmbajtje: “Nga tarifa 27 dhe 28 lirohen automjetet me peshë mbi 3.5 ton, të auto-shkollave gjatë aftësimit të kandidatëve për kategoritë përkatëse (C-D)”.

Neni 3.

1. Te neni 8 i rregullores bazë, shtohen tarifat si në vijim:

Lartësia e pagesës për kontrollin e therrijës

Nr. tar	Shërbimet:	Lartësia e pagesës
Mishi i gjedhit		
1	Gjedhet	5 € / për krerë
2	Viqat	2 € / për krerë
3	Njëthundrakët	3 € / për krerë
Mishi i derrit sipas peshës së Kërkasave		
1	Më pak se 25 Kg.	0,5 € / për krerë
2	25 Kg. e më shumë	1 € / për krerë
Mishi i dheneve dhe dhive sipas Peshës së karkasave		
1	Më pak se 12 Kg.	0.15 € / për krerë
2	12 Kg. e më shumë	0.25 € / për krerë
Shpezët		
1	Pulat	0.01€ / copë

Neni 4

1. Te rregullorja bazë, neni 10, paragrafi 2, pika 2.1;2.2;2.3;2.4, paragrafi 3, pika 3.1;3.2; dhe 3.3, si dhe paragrafi 4 fshihen.
2. Te rregullorja bazë, neni 13 paragrafi 1 fshihet, paragrafi 2 dhe 3 shndërrohet në nen sipas radhës.

Neni 5

Pas miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve në rregulloren bazë, bëhet teksti i spastruar i rregullores bazë.

Neni 6

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr. 016-122568
Gjilan , më 29.12.2015

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku Rexhepi

Arsyetimi

Rregullorja mbi ndryshimet dhe plotësimet e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, **01. nr. 016-26468 e dt. 11.03.2015** është i bazuar në dispozitat e neneve 8, 12-16 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049, (GZ. e Republikës së Kosovës, nr. 27 e datës 03.06.2008) si dhe dispozitat e Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014.

Me këtë Projekt parashihet ndryshimi, plotësimi dhe harmonizimi i rregullores aktuale në dispozitat që prekin shërbimet publike komunale, shërbimet ne bujqësi sa i përket kontrollit të therjes së kafshëve dhe në kadastrë.

- Në shërbimet publike kemi harmonizim të taksave dhe riformulim të tyre e sidomos në infrastrukturë me qëllim që të ruhet infrastruktura gjegjësisht prerja apo gropimi i rrugëve etj;
- Nga Drejtoria e Bujqësisë janë caktuar tarifatat për shërbimet që kryhen në kontrollin e therrjës së kafshëve në teritorin e komunës së Gjilanit nga ispektorët e veterinarisë.
- Në drejtorinë e kadastrit, gjeodezisë dhe pronës janë fshirë tarifatat sa i përket lidhur me dhenien e tokës në shfrytëzim.

Arsyetimi për fshirjen e këtyre tarifave është se me nxjerrjen e ligjit nr. 04/L-040 të dt. 22 nëntor 2012 i cili përcakton se prona komunale ipet në shfrytëzim në bazë të barabarsisë së palëve e cila realizohet me anë të ankandit publik.

Këto tarifa që kanë figuruar në rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoba janë jorelevante dhe si të tilla nuk duhet të parashihen më dhe është propozuar të fshihen.

Lidhur me projekt-ndryshimin e kësaj rregulloreje, në pajtim nenin 17 dhe 18 të Statutit të Komunës së Gjilanit dhe në zbatim të nenit 4 të Rregullores për Transparencë në Komunë dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2013 për Transparencë në Komuna, janë zhvilluar edhe procedurat e dëgjimi publik me qytetarë me datën **27 tetor 2015** ku janë prezantuar qëllimet e ndryshimit të rregullores dhe efektet juridike që mund të ketë.

Kërkesat e qytetarëve sa i përket tarifave dhe taksave ishin si në vijim:

- Kërkesa që të shqyrtohet mundësia që KK-së të lirojë nga taksat lidhur për bartjen e pronësisë për trojet në ish Gavran për të cilat ende një pjesë e tyre figurojnë formalisht në emër të Komunës së Gjilanit,
- Dhe të hiqet tarifa sa i përket kërkesës/ofertës formale që i bahet komunës për blerjen lidhur me transaksonet për shitblerjen e paluajtshmërive kur dihet se komuna asnjë kërkesë për blerjen e ndonjë paluajtshmërije të ofertuar nga ndonjë person nuk është blerë.

Për të dyja këto propozime duhet të paraqitet një arsyetim nga vetë Drejtoria për Gjeodezi, kadastrë dhe pronë lidhur me atë se si të veprohet me këto dy kërkesa. Aktualisht nuk ka ndonjë propozim konkret nga drejtoria përkatëse.

Duke u bazuar

Andaj bazuar në këtë arsyetim dhe në pajtim me nenin **58 shkronja h) të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale dhe në pajtim me nenin 77 nënparagrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Gjilanit i**

PROPOZOJ:

Kuvendit të Komunës së Gjilanit në pajtim me rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe në pajtim me nenin 40.2 pika a) të LVL-së dhe nenit 38 nënparagrafi 1.3 të statutit të Komunës së Gjilanit, të miratojë Rregulloren mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale.